# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-401864**
VERSIONI

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Pronat para viteve '91/ Kadastra hap aplikimin online, përfituesit dhe kush përjashtohet |
| ADRESA | https://www.gazetatema.net/sociale/pronat-para-viteve-91-kadastra-hap-aplikimin-online-perfituesit-dhe-kush-i584280 |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | redirected |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 6 shtator 2026, 12:13:24 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 6 shtator 2026, 12:25:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | 8650a0057f8ae1704caffd31c1504364a099b2e6c2eb9563744a6e317f646356 |
| TEKSTI | ff91640f51f350a1afdaddcea72dc2f698f6058b0dc50837212c3194b40801cc |
| PAMJA | 59e4656f6cef10bd3e3521dc1d6ce559a91fd2375b3ecbe68fbe834396e11456 |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | 911456c6d59aa1f3294e6cee0376927c2849aa6b259c2c77ae89b92373773a9e |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | 0a09a13f159440b4b4b78274a5efc8a257b0de4b0ce6a8edbda97a53218837c6 |
| ANKORUAR | Polygon PoS · bllok 47086362 |
| TRANSAKSIONI | 0x311244189763d8704b23b9152a8422dd79e30a90c1264d1757967b7d25d9e1d2 |
| IPFS | QmRLvSTN7qJX7YU63hBUp5SdxP2zbWfMaJ3xxh6AhHW7vy |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/911456c6d59aa1f3294e6cee0376927c2849aa6b259c2c77ae89b92373773a9e

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Pronat para viteve ’91/ Kadastra hap aplikimin online, përfituesit dhe kush përjashtohet

TemA

6 Shtator 2026, 14:25Sociale TEMA



Pronarët që kanë një shtëpi private dhe oborre në përdorim para vitit ’91 u jepet mundësia të aplikojnë në e-Albania, procedurë e cila do të çojë në pajisjen me certifikatë pronësie sipas ligjit. Pas thirrjes së bërë nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, avokati Redi Ramaj thotë se përjashtim për këtë aplikim bëjnë pallatet e vjetra.

“Duke qenë se futen vetëm këto kategori, pra shtëpi private, nëse mund ta themi në këtë formë, dhe oborret që përdorim të këtyre shtëpive private, përjashtohen ose futen në procese të tjera.Nëse banon në një ndërtesë, pra në një pallat, i cili është ndërtuar para vitit 1991 dhe ke probleme me dokumentacionin e pronësisë, ose ke bërë ndërtim të ri pas vitit 1991, futesh në procesin e legalizimit dhe jo në këtë procedurë ose aplikim që ka nxjerrë ASHK-ja”, u shpreh avokati.

Sipas avokatit Ramaj janë të shumta rastet e qytetarëve që përdorin banesat mbi 60 vite ende me problematika, për të cilat zgjidhja nuk kërkon shumë kohë.

“Edhe pse jemi me vonesë, nëse do të trajtoheshin rastet, do t’u jepej një mundësi shumë e mirë qytetarëve për t’u pajisur me certifikatë, sepse aplikimet janë të shumta. ASHK-ja, në këtë mënyrë, duke qenë se bëhet fjalë për objekte të vjetra, të qëndrueshme dhe të pandryshuara prej vitesh, mund t’i zgjidhë shumë shpejt, pra në një kohë relativisht të shkurtër, nga një muaj deri në tre muaj”, tha Ramaj.

Kadastra ka bërë publike hapave që duhen ndjekur për aplikimin, për të cilat qytetarit i duhet që në llogarinë e tij në portalin e-Albania të zgjedhë shërbimin “Aplikim për regjistrimin e kalimit të pronësisë me anë të ligjit, me vendim të gjykatës, apo të një akti administrativ” dhe klikimin e opsionit “Përdor”. Aplikanti krijon gjithashtu një aplikim të ri ku me plotësimin e të dhënave të kërkuara nga sistemi shton nën shërbimin “Regjistrim i kalimit të pronësisë me anë të aktit administrativ të lëshuar nga ASHK”. /rtsh

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Njerëzit që pastrojnë Tiranën/ Flasin ata që punojnë kur të tjerët flenë: Nuk na lodh puna, por sjellja e qytetarëve

13:40 Sociale / 1 koment

[Nis evidentimi dhe vlerësimi i dëmeve nga zjarret, Gogu: Ditë të vështira për shumë komunitete, mirënjohje forcave në terren]

12:35 Sociale

[Levani bëhet “zi”, zjarret “përpijnë” 6 fshatra. Banorët me lot në sy]

21:45 Sociale / 2 komente

[Nis evidentimi i dëmeve nga zjarri në Himarë, Tavo: Po identifikohen familjet e prekura]

16:45 Sociale / 1 koment

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.